



Pranimi / Dorezimi Prilazja / Prilazja Received / Delivery	16.05	2022	2	viti god year
Organ / Djepia Organ / Jednica Org / Unit	SKINSHUK	2846/2022	113	Sasia Kolicina Quantity



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.333/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Avdyl Bektashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.1898/2022 të datës 06.04.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga

kundër organit të punësimit/Komunës së Vitisë, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 16.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.333/2022 e datës 06.04.2022 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Komuna e Vitisë më datë 31.01.2022 ka njoftuar që nga data 21.02.2022 deri më datë 04.03.2022 do të lejohet aplikimi për grupin e pozitive "Specialist i Administrimit të Përgjithshëm" respektivisht "Zyrtar i Gjendjes Civile 1". Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, i cili nga Njësia e Burimeve Njerëzore është përfshirë në listën e shkurtër dhe i cili është nënshtruar testit me shkrim duke marrë 49 pikë, ndërsa pas vlerësimit të jetëshkrimit dhe intervistës me gojë ka marrë 66.64 pikë. Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Vitisë më datë 28.03.2022 ka publikuar njoftimin përfundimtar për kandidatët fitues për "Specialist i Administrimit të Përgjithshëm" respektivisht "Zyrtar i Gjendjes Civile 1", në bazë të cilit ankuesi nuk është kandidatë që ka marrë 70 pikë, rrjedhimisht nuk është kandidat fitues.

Ankuesi përmes postës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil

të Kosovës e cila më datë më datë 06.04.2022 është pranuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe është regjistruar me numër të ankesës A.nr.333/2022 dhe Nr. Prot: 1898/2022, me pretendimet ankimore kundër komisionit të vlerësimit për konkursin "Specialist i Administrimit të Përgjithshëm".

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konform dispozitave Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 12.04.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Komunën e Vitisë, ndërsa, Këshilli ka pranuar shkresat lidhur me çështjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.Prot:1898/2022 të datës 06.04.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Zarkin; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 12.04.2022; Përgjigjen në ankesë; Vendimi për verifikim paraprak; Listën e aplikantëve; Njoftim për rezultatet preliminare të verifikimit paraprak të kandidatëve i datës 09.03.2022; Konkurs për "Specialist i Administrimit të Përgjithshëm" respektivisht "Zyrtar i Gjendjes Civile 1" të shpallur nga Komuna e Vitisë; Njoftimin e datës 14.03.2022 nga Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore; Vendimin e datës 08.03.2022 për themelimin e komisionit të pranimit; Njoftimin për rezultatin e vlerësimit grup "Specialist i Administrimit të Përgjithshëm" i datës 24.03.2022; Njoftimin përfundimtar për kandidatët fitues i datës 28.03.2022; Emailin e datës 24.03.2022; Renditjen përfundimtare të kandidatëve.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, **është e palejuar, SEPSE:**

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Komuna e Vitisë më datë 28.03.2022 ka publikuar njoftimin përfundimtar për kandidatët fitues për "Specialist i Administrimit të Përgjithshëm" respektivisht "Zyrtar i Gjendjes Civile 1", në bazë të të cilit ankuesi nuk është kandidatë që ka marr 70 pikë, rrjedhimisht nuk është kandidat fitues.

Ankuesi kundër këtij procesi të pranimit nuk ka sjell asnjë dëshmi me të cilën dëshmohet që kundër këtij procesi ka bërë ankesë të brendshme një njësinë përgjegjëse siç parashihet me nenin 25 paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"Kundër rezultatit të fazës së vlerësimit, kandidati i pakënaqur, mund të parashtojë ankesë të brendshme, brenda tri (3) ditëve nga data e njoftimit individual"*, ndërsa ankesa shqyrtohet nga Komisioni i Pranimit dhe vendimi njoftohet brenda shtatë (7) ditëve nga paraqitja e saj siç parashihet me paragrafin 6 të këtij neni.

Bazuar në këtë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankesa në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër një procesi të pranimit në shërbimin civil, parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës së brendshme të ankesës tek organi përkatës siç parashihet me nenin 31 paragrafi 1 dhe 2 Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"1.Kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil, i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (në vijim në tekstin e*



kësaj Rregullore "Këshilli"). 2. Ankesa në Këshill parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës të organit përkatës që ka nxjerrë aktin apo kryer veprimin që kundërshtohet", si rrjedhojë meqenëse nuk ka asnjë dëshmi që ankuesi të ketë parashtruar ankesë të brendshme tek organi i punësimit, atëherë sipas Kolegjit për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, kandidatit në procedurë të pranimit nuk i lejohet të parashtoj ankesë drejtpërdrejtë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pa i shterur procedurat e brendshme të ankesave, mbi këtë bazë ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është në kundërshtim me nenin 16 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton se: "Para parashtrimit të ankesës në Këshill, nëpunësi civil apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t'i ketë shteruar procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit, nëse me ligj të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe", po ashtu ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është në kundërshtim me nenin 125 paragrafi 1 dhe nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, dhe si e tillë është e papranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.333/2022, datë 16/05/2022

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankuesit,
- ❖ Kryetarit të Komunës së Vitisë;
- ❖ Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Vitisë; dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.